

Sylvinho, ylli më i madh i Kombetares është trajneri

nga Gent Mebelli
E premte, 05 Prill 2024 00:00

Sylvinho, ylli më i madh i Kombetares është trajneri

Në janar të 2023, një emër i madh mori drejtimin e kombëtaren e Shqipërisë.



Sylvinho sot 49-vjec, dikur ne fillim te viteve 2000 luajti gjashtë herë për Seleção, pot talenti i tij nuk do te ishte i mjaftueshm për më shumë ndeshje ndërkombëtare.

Ai ishte një mbrojtës i majtë dhe pothuajse në të njëjtën moshë me te, një djale qe quhej Roberto Carlos e kishte pervetesur perfundimisht per vite me rradhe hapësirën në krahun e majte te Brasilit.

Sylvinho, ylli më i madh i Kombetares është trajneri

nga Gent Mebelli
E premte, 05 Prill 2024 00:00

Sylvinho fitoi famë kryesisht gjatë kohës së tij në FC Barcelona.

Nga viti 2004 deri në vitin 2009 ai luajti gjithsej 128 ndeshje konkurruese për katalanasit dhe fitoi dy herë Ligën e Kampionëve me ta.

Ai gjithashtu luajti për Arsenalin dhe Celta Vigo në Evropë dhe më pas e përfundoi karrierën e tij në Manchester City në 2009/10.

Gent Mebelli